



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 26/2018 (JR)
Datë 25.10.2018

Vendim nr. 7 (JR)
Datë 05.04.2019

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Ardian Hajdari	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Luan Daci	Anëtar

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 05.04.2019, ora 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 26, datë 25.10.2018, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Elision Sadiku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 50, datë 27.07.2018, për subjektin e rivlerësimit Elision Sadiku.

BAZA LIGJORE Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni F i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe aktet bashkëlidhur tij, si dhe

parashtrimet me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit para seancës gjyqësore, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin nr. 50, datë 27.07.2018, ka vendosur:
 - *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Elision Sadiku, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.*
 - *Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe Vëzhguesve Ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
 - *Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

II. Shkaqet e ankimit

2. Kundër vendimit të Komisionit nr. 50, datë 27.07.2018, është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji) nga subjekti i rivlerësimit Elision Sadiku, i cili kërkoi ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrë.
3. Në vijim të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj kërkesën nr. {***} prot., datë 17.12.2018, për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe marrjen e provave të reja, të paraqitura me ankimin.
4. Në përmbajtje të ankimit të subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku, si shkaqe ankimi evidentohen sa më poshtë vijon:

A. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë

4.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit për vlerësimin e kriterit të pasurisë, që është krejtësisht i ndryshëm nga raporti i ILDKPKI-së, nuk është bazuar në prova të tjera, të reja dhe nuk është i argumentuar në drejtim të arritjes së një konkluzioni të ndryshëm me atë të ILDKPKI-së.

4.2. Subjekti pretendon referim të gabuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës nga ana e Komisionit në vendim, pasi kjo dispozitë nuk gjen aplikim në rastin e kontrollit të pasurisë së tij, duke qenë se subjekti nuk është as në kushtet e mosdorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe as nga Komisioni nuk është konkluduar se subjekti ka fshehur pasurinë, ka bërë deklaram të rremë apo ka bërë përpjekje për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij gjatë procesit të rivlerësimit dhe ky fakt përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim KEDNj).

4.3. Subjekti pretendon referim të gabuar në nenin 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 nga ana e Komisionit, për sa kohë, sipas tij, referuar raportit të ILDKPKI-së dhe vlerësimit të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar dhe as disponojnë dyfishin e pasurisë së ligjshme në raport me të ardhurat e tyre të ligjshme, sikundër dhe nuk përmbushen në mënyrë kumulative kriteret e përcaktuara në nenin 61, pika 3, sa i takon deklarimit të pamjaftueshëm.

4.4. Subjekti kundërshton vendimin e Komisionit në lidhje me vlerësimin e bërë për ekzistencën e marrëdhënies së punësimit të bashkëshortes së tij përpara datës 01.07.2009 dhe trajtimin financiar përkatës, duke pretenduar se ky konkluzion është rezultat i vlerësimit të gabuar të fakteve, si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të provave të administruara, si dhe shpjegimeve të subjektit lidhur me faktet që ato përmbajnë. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti argumenton se:

4.4.1. Provat e paraqitura prej tij që konsistojnë në deklaratat noteriale të punëdhënësit të pretenduar të bashkëshortes së tij, të dy pacientëve të klinikës dhe bllokut të pacientëve të klinikës dentare {***}, të vlerësuara në unitet me njëra-tjetrën dhe në raport me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe deklarimeve periodike vjetore të kryera prej tij, provojnë marrëdhënien e punës dhe krijimin e të ardhurave prej saj.

4.4.2. Sa i takon detyrimin për deklarimin e pagës në organet tatimore, subjekti pretendon se ky detyrim ligjor është i punëdhënësit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi punëmarrësin, në këtë rast bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit.

4.5. Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit në lidhje me vlerësimin si deklarim të pasaktë të të ardhurave të personit të lidhur, bashkëshortes M.S, në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë të vitit 2009, për shumën 488896 lekë, që përfaqëson diferencën midis të ardhurave të pretenduara si të marra faktikisht në shumën prej 540.000 lekësh dhe vlerës së të ardhurave prej 91.104 lekësh, për të cilat është bërë deklarimi pranë organeve tatimore, si dhe janë paguar tatimet. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti pretendon se ka deklaruar me saktësi të ardhurat e marra në masën e përfituar faktikisht, pavarësisht se punëdhënësi ka deklaruar punësimin e bashkëshortes së tij pranë organeve tatimore me pagë minimale dhe ka shlyer detyrimet tatimore përkatëse të përlllogaritura sipas kësaj page.

4.6. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me deklarimin e kryer në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2009, sa i takon pakësimin të pasurisë së tij të deklaruar më parë nëpërmjet shitjes së automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, si dhe mosdeklarimit të vlerës së çmimit të shitjes prej 400.000 lekësh, duke pretenduar se ka kryer deklarim të saktë, për sa kohë gjatë atij viti nuk ka pasur shtim pasurie dhe se vlera prej 400.000 lekësh është përdorur prej tij brenda të njëjtit vit, për blerjen e një automjeti tjetër.

4.7. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me deklarimin e të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës gjatë vitit 2006, si deklarim të pasaktë, duke pretenduar se deklarimi i këtyre të ardhurave dy herë brenda vitit 2006 është “një gabim minimal njerëzor, tërësisht i paqëllimtë”.

4.8. Subjekti kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni duke pretenduar se:

- 1) Blerja e pajisjeve të përdorura dentare në vitin 2013 nga bashkëshortja, znj. M.S, mbulohet me të ardhura të ligjshme nga punësimi.
- 2) Nuk janë marrë në analizë nga Komisioni, në mënyrë të saktë, shpjegimet e dhëna nga subjekti me analizën financiare të depozituar prej tij dhe në vendim janë reflektuar gabim përlllogaritjet e shpenzimeve të bëra nga vetë subjekti.
- 3) Në vendim, Komisioni nuk ka shpjeguar se cila është metodologjia e përdorur për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, si dhe sa u takon shpenzimeve për udhëtimet e subjektit jashtë territorit të Shqipërisë, subjekti pretendon se ato janë llogaritur gabim.
- 4) Në analizën financiare të vitit 2011 të bërë nga Komisioni, në të cilën subjekti del me një balancë negative prej (-) 279.630 lekësh, nuk është përfshirë vlera prej 200.000 lekësh *cash*, e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës.
- 5) Për vitin 2013, balanca negative prej (-) 317.328 lekësh ka ardhur si pasojë e mospërfshirjes në analizën financiare, të bërë nga Komisioni, të kursimeve të bashkëshortes së subjektit nga pagat e përfituara (janar 2007 - dhjetor 2008), si dhe janë përlllogaritur gabim kostot e shpenzimeve të jetesës dhe ato të udhëtimeve.

4.9. Subjekti pretendon se Komisioni në vendimmarrjet e tij për subjekte të tjera të rivlerësimit ka krijuar standarde të dyfishta në trajtimin e diferencave të rezultuara të pambuluara me burime të ligjshme nga analiza financiare e subjekteve të rivlerësimit, duke referuar diferencat e pambuluara që kanë rezultuar nga analiza financiare e Komisionit për vitet 2011 dhe 2013, si dhe në vlerësimin e pasaktësive në deklaratat periodike, apo ndonjëherë edhe ato në deklaratën e pasurisë *vetting*, të cilat nuk janë konsideruar si shkak për shkarkimin nga detyra të subjekteve të tjera të rivlerësimit.

B. Shkaqe ankimi që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale

4.10. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e arritura nga Komisioni për denoncimin e shtetasit A.D, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2014, si të pabazuara në ligj dhe në prova. Subjekti pretendon se hetimi i kryer prej tij, lidhur me këtë procedim penal ka qenë i thelluar, i plotë dhe shterues dhe se veprimet hetimore, për të cilat Komisioni pretendon se nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, megjithëse të panevojshme, duhet të ishin kryer nga autoritet kompetente bullgare dhe jo prej tij.

4.11. Subjekti pretendon se Komisioni, në kundërshtim me përcaktimet e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, ka shqyrtuar çështjen penale që lidhet me denoncimin e shtetasit A.LI (në emër të shtetasit M.M), edhe pse ajo është çështje ende në shqyrtim, si dhe ka tejkuluar parashikimet ligjore lidhur me kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve, si pasojë e vlerësimit të thelbit të vendimmarrjes së prokurorit, në lidhje me trajtimin e çështjes penale në fjalë, dhe jo vlerësimin e subjektit, sipas standardeve të përcaktuara nga neni E i Aneksit të Kushtetutës.

4.12. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e arritur nga ana e Komisionit mbi klasifikimin “me mangësi” në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 44, shkronja “b” e

ligjit nr. 84/2016) vetëm mbi bazën e dy denoncimeve, si të pambështetur në ligj dhe në prova.

4.13. Subjekti pretendon zbatim të gabuar të ligjit nga ana e Komisionit në arritjen e konkluzionit se ai ka cenuar besimin e publikut (sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016) vetëm mbi bazën e dy denoncimeve të dy personave që kanë pasur probleme me ligjin, duke qenë se besimi i publikut të gjerë nuk mund të përfaqësohet nga këta dy denoncues.

5. Në ankim dhe parashtime, subjekti i rivlerësimit, së bashku me shkaqet e ankimit, ka kërkuar marrjen në cilësinë e provave të reja, të dokumenteve të mëposhtme.

5.1. “Akt ekspertimi grafik shkrimi” nr. {***}, datë 08.10.2018, kryer për ekspertimin e shkrimit në librin e pacientëve të klinikës dentare {***}, me të cilin subjekti pretendon të provojë faktin se bashkëshortja e tij, znj. M.S, ka qenë e punësuar nga punëdhënësi S.B, prej vitit 2007 (stazhi profesional në vitin 2006 dhe punësimi në vitin 2007 e në vijim) për shkak të lënies së disa shënimeve me shkrim prej saj në këtë libër.

5.2. “Deklaratë noteriale” e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. M.S, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.10.2018, pranë noterit publik B.Z, me anë të së cilës subjekti pretendon të provojë faktin e punësimit të bashkëshortes së tij pranë punëdhënësit S.B prej vitit 2007.

5.3. “Deklaratë noteriale” e shtetasit G.K, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.10.2018, pranë noterit publik B.Z, dhe “Deklaratë noteriale” e shtetasit R.T, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.10.2018, pranë të njëjtit noter publik. Me anë të këtyre deklaratave noteriale, subjekti i rivlerësimit pretendon të provojë faktin e punësimit të bashkëshortes së tij si mjek stomatolog pranë punëdhënësit S.B (fillimisht si stazhiere në vitin 2006 dhe nga viti 2007 e në vijim si e punësuar).

5.4. Shkresë nr. {***} prot., datë 08.10.2018, e Prokurorisë së Përgjithshme dhe praktika bashkëlidhur saj. Vërtetim nr. {***} prot., datë 08.10.2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, kopje e prezantimit në aktivitetin e zhvilluar në datën 4 qershor 2013, në Sofje, Bullgari. Me anë të këtyre shkresave, subjekti i rivlerësimit pretendon të provojë faktin se shpenzimet e udhëtimit në Bullgari, në vitin 2013 janë mbuluar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe FBI (organizatori), dhe jo prej tij.

5.5. Vërtetim nr. {***} prot., datë 05.10.2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë. Me anë të këtij vërtetimi, subjekti i rivlerësimit pretendon të provojë faktin që çështja penale me kallëzues M.M (denoncuar pranë Komisionit nga përfaqësuesi i tij A.Ll) është ende në proces hetimi dhe e papërfunduar me një vendim gjyqësor.

III. Rrethanat e çështjes

6. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”. Subjekti i rivlerësimit Elsion Sadiku i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 279, pika 4 e

ligjit nr. 115/2016¹ “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke qenë se ishte kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

7. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht: deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
8. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar, duke konkluduar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Elision Sadiku”.
10. Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.
11. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme, kreu procedurën e rivlerësimit për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale) dhe mbylli procesin e rivlerësimit kalimtar me vendimin nr. 50, datë 27.07.2018.
12. Vendimi i Komisionit nr. 50, datë 27.07.2018, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku, është marrë bazuar në nenin 179/b, nenin D, pikat 1, 3 dhe 5, dhe nenin E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 44, pika b, 58, pika 1, shkronja “c”, dhe 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

12.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, sepse ka pasaktësi në deklaramin e burimeve financiare, deklaram të pamjaftueshëm të të ardhurave, ka burime financiare të paligjshme, si dhe balancë financiare negative për vitet 2011 dhe

¹ Neni 279, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon:

4. Brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit bën rivlerësimin e prokurorëve që kandidojnë. [...]

2013, duke bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë (neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016).

12.2. Në lidhje me kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës (neni 59/b i ligjit nr. 84/2016).

12.3. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit është “me mangësi” (neni 44/b i ligjit nr. 84/2016).

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për gjykimin e çështjes në seancë publike dhe marrjen e provave të reja

13. Sa i takon kërkesës së subjektit të rivlerësimit të depozituar në Kolegj, më datë 13.12.2018, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe marrjen e provave të reja që i bashkëlidhen ankimit, si dhe çdo prove tjetër që Kolegji do ta konsiderojë të nevojshme, përveç provave të sugjeruara prej tij, si dhe përsëritjen e marrjes në shqyrtim të një pjese të provave të paraqitura nga subjekti në Komision, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, në kuadër të konstatimit në mënyrë të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me ekzistencën e marrëdhënies së punës së bashkëshortes së tij, trupi gjykues vlerësoi se marrja e provave të reja dhe përsëritja e marrjes së disa provave të marra në Komision ishin të panevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe, për rrjedhojë, bazuar në nenin 47 dhe nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, dhe nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, vendosi refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentacionit të fashikullit të çështjes së përcjellë nga Komisioni.

B. Lidhur me shkaqet e ankimit që kanë të bëjnë me kriterin e kontrollit të pasurisë

14. Në vlerësim të shkakut të ankimit sipas paragrafit 4.1 më sipër, me anë të të cilit subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit për vlerësimin e kriterit të pasurisë është krejtësisht i ndryshëm nga raporti i ILDKPKI-së, dhe se kjo vendimmarrje as nuk është bazuar në prova të tjera/të reja, dhe as nuk është argumentuar në drejtim të arritjes së një konkluzioni të ndryshëm me atë të ILDKPKI-së, trupi gjykues, në konsideratë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore që përcaktojnë kompetencat e organeve të rivlerësimit, parë këto në raport me vlerësimet e organeve të tjera të përfshira në vlerësimin e tri kriterëve të këtij procesi, si dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, datë 18.01.2017, sipas të cilit organet e tjera të përfshira në procesin e rivlerësimit kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale, për të ndihmuar institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre, arrin në konkluzionin se institucionet e rivlerësimit nuk janë të detyruara të ndjekin apo të kenë qëndrime e konkluzione të njëjta me ILDKPKI-në, por janë të autorizuara nga Kushtetuta dhe ligji të bëjnë hetimet e tyre, për të kryer një proces rivlerësimi të pavarur e të pandikuar nga konkluzionet e institucioneve ndihmëse. Ky qëndrim është konfirmuar edhe në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit, për rrjedhojë trupi gjykues arrin në përfundimin se ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj.

15. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.2 më sipër, sipas të cilit subjekti pretendon se Komisioni në mënyrë të gabuar ka referuar në vendimin e tij pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke bazuar vendimmarrjen e tij edhe në këtë dispozitë Kushtetuese, në kushtet kur kjo nuk gjen zbatim në rastin e kontrollit të pasurisë së subjektit, për sa kohë subjekti nuk është as në kushtet e mosdorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe as nga Komisioni nuk është arritur në përfundimin se subjekti ka fshehur pasurinë, ka bërë deklaram të rremë, apo ka bërë përpjekje për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar arsyesimit të vendimit objekt shqyrtimi, konstaton se Komisioni nuk ka arritur në konkluzionin se subjekti ndodhet në kushtet e përpjekjes për të fshehur pasurinë e tij dhe as i ka kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën. Kolegji vlerëson se referenca ligjore në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, lidhet me pasaktësitë në deklarime që kanë rezultuar nga procesi i verifikimit, në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit dhe personave të lidhur me të dhe, për rrjedhojë, pretendimi për cenim të procesit të rregullt në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, vlerësohet nga trupi gjykues si i pabazuar.
16. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.3 më sipër, mbi referimin e gabuar në vendimin nr. 50, datë 27.07.2018, të Komisionit në nenin 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon si më poshtë.

16.1. Sa i takon pretendimit në lidhje me referencën në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton se referenca ligjore e përcaktuar në mënyrë të shprehur në pjesën që u takon dispozitave ligjore, mbi bazën e të cilave është marrë vendimi nga ana e Komisionit, në përputhje me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, nuk e përfshin pikën 1 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, as në pjesën arsyetuese të vendimit nr. 50, datë 27.07.2018, nuk referohet nga Komisioni se një ndër shkaqet që e kanë çuar atë në marrjen e vendimit për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit të jetë ai i deklaramit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, i përcaktuar në dispozitën e sipërcituar. Në konkluzionet e dhëna nga ana e Komisionit në vendim, lidhur me secilin prej kriterëve të kontrollit, vihet re se sa i takon kriterit të kontrollit të pasurisë, subjekti referohet se nuk ka arritur nivel të besueshëm, si pasojë e pasaktësive në deklaramin e burimeve financiare, deklaramit të pamjaftueshëm të të ardhurave, burimeve financiare të paligjshme, si dhe balancës financiare negative për vitet 2011, 2013, duke e kualifikuar atë si subjekt që ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për referim të gabuar nga ana e Komisionit, sa i takon referencës ligjore në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i bazuar.

16.2. Në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me referencën e gabuar nga ana e Komisionit në vendimin e tij në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me argumentin se dispozita në fjalë kërkon përmbushjen në mënyrë kumulative të dy kriterëve, atij të deklaramit të pamjaftueshëm nga subjekti për kontrollin e pasurisë dhe atij të figurës, trupi gjykues vlerëson se interpretimi literal që subjekti i rivlerësimit i bën dispozitës ligjore në fjalë, është i gabuar dhe nuk mbështetet në frymën e përgjithshme të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të procesit të rivlerësimit, në mënyrë të posaçme në parashikimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit përcaktohet shprehimisht se vendimi për rivlerësimin e subjekteve mund të merret duke u bazuar edhe vetëm në një prej kriterëve të vlerësimit. Ky qëndrim është konfirmuar edhe në vendimmarrje të

mëparshme të Kolegjit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e çmon të pabazuar në ligj këtë shkak të ankimit.

17. Në shqyrtim të shkakut të ankimit sipas paragrafit 4.4 më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit Elision Sadiku ka kryer deklarin e tij të parë të pasurisë (deklarata e interesave privatë para fillimit të detyrës) në nëntor të vitit 2006. Në momentin e këtij deklarimi, subjekti i rivlerësimit ka qenë i pamartuar. Në vijim, në deklarin periodik të pasurisë për vitin 2008, përveç subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar për herë të parë, në cilësinë e personit të familjes (bashkëshortes së subjektit) që mbart detyrimin për deklarin të pasurisë sipas neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, edhe znj. M.S. Në këtë deklarin, znj. S. ka deklaruar si pasuri likuiditete në formën e parave *cash* vlerën prej 500.000 lekësh si dhuratë nga babai i saj, si dhe një kursim me vlerën prej 1.000.000 lekësh, me burim të ardhurat nga puna e saj si stomatologe. Subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesën në janar të vitit 2009. Në të gjitha deklarinet periodike vijuese të pasurisë, pas atij të vitit 2008, përveç subjektit të rivlerësimit, ka kryer deklarin edhe bashkëshortja e tij.
18. Në ankimin e tij subjekti i rivlerësimit pretendon vlerësim të gabuar nga Komisioni, sa i takon ekzistencës së marrëdhënies së punësimit të bashkëshortes së tij përpara datës 01.07.2009 dhe trajtimit financiar përkatës, duke pretenduar se ky konkluzion është rezultat i vlerësimit të gabuar të situatës faktike, si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të provave të administruara, si dhe shpjegimeve të subjektit lidhur me faktet që ato përmbajnë. Subjekti pretendon se provat e paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ, si dhe gjatë seancës dëgjimore, nuk janë analizuar nga Komisioni, pasi ai nuk është shprehur për vlerën provuese të tyre.
19. Lidhur me pretendimet e mësipërme, trupi gjykues konstaton se në fashikullin e gjykimit në Komision janë administruar shpjegimet që ka paraqitur subjekti, lidhur me rezultatet paraprake të hetimit administrativ, të protokolluara në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 18.07.2018, si dhe aktet e mëposhtme.
 - i. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2018, e shtetasës V.A.B.
 - ii. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2018, e shtetasit S.E.A.
 - iii. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2018, e shtetasit S.B.
 - iv. Të dhëna nga sistemi Tims për hyrje-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë të shtetasit S.B.
 - v. Blloku i operimeve i klinikës dentare {***}.
 - vi. Fotografi të M.S në ambientet e punës në klinikë, e pretenduar të jetë e vitit 2006.
20. Për provat e sipërcituara, trupi gjykues konstaton se Komisioni është shprehur në vendim, si më poshtë:

*Pavarësisht provave dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si: deklarata noteriale e pronarit të klinikës dentare {***} dhe të dy klientëve të saj, listës së klientëve të klinikës dentare, fotokopjes së librezës së punës së bashkëshortes, sqarimeve të*

pyetësorëve etj., konfirmohet fakti se nuk rezulton e provuar me asnjë dokumentacion ligjor, si dhe nga asnjë institucion shtetëror apo privat, që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. S., të ketë qenë e punësuar, punësim për të cilin të ketë paguar detyrimet tatimore, para datës 01.07.2009 e, për rrjedhojë, të ketë përfituar pagesa përpara kësaj date në shumën totale prej 1.000.000 lekësh.

[...] subjekti ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur; si dhe [...] Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë: [...] ç) deklaratimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; d) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancë dëgjimore.

21. Referuar sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni nuk rezulton të ketë marrë vendim për refuzimin e marrjes si prova të akteve të mësipërme, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, por përkundrazi, pasi i ka marrë në shqyrtim ato në mënyrë individuale, ka çmuar vlerën e tyre provuese, në raport me të gjitha provat e tjera dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me faktin e pretenduar nga ky i fundit mbi ekzistencën e marrëdhënies së punës së bashkëshortes së tij me punëdhënësin S.B. Fakti që Komisioni ka bërë një vlerësim të këtyre provave sipas bindjes së brendshme të anëtarëve të trupit gjykues, i cili rezulton i ndryshëm nga vlerësimi që iu bën subjekti i rivlerësimit, nuk mund të nënkuptojë se Komisioni nuk i ka marrë ato në shqyrtim.
22. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues pasi i vlerësoi provat e sipërcituara, në mënyrë individuale si dhe në tërësinë e tyre, në raport edhe me shpjegimet e dhëna nga subjekti në Komision, si dhe me pretendimet e ngritura në ankim, arrin në përfundimin se Komisioni ka konstatuar në mënyrë të drejtë situatën faktike nëpërmjet provave të marra në shqyrtim, duke arritur në konkluzionin se nuk provohet nga asnjë dokumentacion ligjor ekzistenca e një marrëdhënieje punësimi midis bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit S.B, ku punëmarrësi ofron shërbimin e rënë dakord dhe punëdhënësi, në respektim të legjislacionit në fuqi, kundërshtëpërblen punëmarrësin nëpërmjet pagës, si dhe i garanton atij të gjitha të drejtat e tjera. Provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të trupit gjykues, nuk arritën të provojnë ekzistencën e elementeve të detyrueshme për një marrëdhënie punësimi (ofrimin e punës në mënyrë periodike të vazhdueshme, kohëzgjatjen ditore/javore/mujore të ofrimit të punës, si dhe kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, përfitimin periodik të shpërblimit të punës (pagës), si dhe të të drejtave të tjera që burojnë prej saj), ndaj në këto kushte nuk qëndron as pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se detyrimin për deklaratim pranë organeve tatimore e ka pasur punëdhënësi S.B.
23. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së deklaruar në formën e likuiditetit *cash*, në vlerën e 1.000.000 lekëve, të deklaruar nga personi i lidhur në vitin 2008. Duke qenë se kjo pasuri është deklaruar si burim për krijimin e pasurive të tjera në vitin 2013, ajo nuk plotëson kriteret e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar si e ardhur e krijuar nga një burim i ligjshëm dhe për të cilën të jenë paguar detyrimet tatimore, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në kohën e krijimit.
24. Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.5 më sipër, sa i takon kundërshtimit të subjektit për konkluzionin e Komisionit se subjekti ka kryer deklaratim të pasaktë të të

ardhurave të personit të lidhur, bashkëshortes M.S, në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë të vitit 2009, në shumën 488.896 lekë, me pretendimin se ai ka deklaruar me saktësi të ardhurat e marra në masën e përfituar faktikisht, pavarësisht se punëdhënësi ka deklaruar punësimin e bashkëshortes së tij pranë organeve tatimore me pagë minimale dhe ka shlyer detyrimet tatimore përkatëse të përlllogaritura sipas kësaj page, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim provat shkresore të administruara në fashikullin gjyqësor, konstaton se në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar si të ardhura të bashkëshortes së tij vlerën prej 540.000 lekësh, ndërkohë që bashkëshortja e tij rezulton si punëmarrëse e deklaruar rregullisht dhe në përputhje me ligjin pranë punëdhënësit *person fizik që ushtron aktivitet si klinikë dentare {***}*, prej datës 1.07.2009 - 31.12.2009, me pagë neto mujore prej 15.184 lekësh. Për rrjedhojë, të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur, nga paga e saj si e punësuar, janë në masën 91.104 lekë dhe jo 540.000, sa rezulton të jenë deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur.

25. Në funksion të vlerësimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për deklarim të saktë të të ardhurës së përfituar faktikisht gjatë vitit 2009, trupi gjykues mori në analizë edhe deklaratimet e vitit 2010, nga të cilat rezulton që për periudhën 01.01.2010 - 31.12.2010, personi i lidhur ka përfituar një pagë vjetore neto prej 192.000 lekësh ose 16.000 lekësh neto në muaj, kurse për vitin 2011 ka deklaruar realizimin e të ardhurave nga paga në masën e pagës neto vjetore, në vlerën prej 195.560 lekësh, ose 16.297 lekësh në muaj. Trupi gjykues konstaton se paga mujore neto, për vitet 2010 dhe 2011, është pothuajse e njëjtë me pagën mujore neto të periudhës së deklaruar pranë organeve tatimore në vitin 2009. Trupi gjykues vlerëson se është alogjike të pranohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit dhe i shtetasit S.B se personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) në vitet 2010 dhe 2011 ka marrë një pagë rreth 3 herë më të vogël sesa paga prej 450.000 lekësh që ajo ka marrë gjatë periudhës 1 janar 2007 deri më 31.12.2009, pasi nuk ka asnjë shpjegim se ndërsa eksperiencia e saj profesionale me kalimin e viteve është rritur, paga e saj reale është zvogëluar gati trefish, edhe pse marrëdhënia pretendohet e vazhdueshme dhe me të njëjtin punëdhënësi.
26. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.6 më sipër, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshton vendimin e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me deklarimin e kryer në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2009, sa i takon mosdeklarimit të vlerës së çmimit të shitjes së automjetit prej 400.000 lekësh, duke pretenduar se ka kryer deklarim të saktë, për sa kohë gjatë atij viti nuk ka pasur shtim pasurie dhe se vlera prej 400.000 lekësh është përdorur prej tij brenda të njëjtit vit, për blerjen e një automjeti tjetër, trupi gjykues konstaton se:
- i. Referuar deklaratës periodike të vitit 2008, subjekti ka deklaruar blerjen me kontratë noteriale të datës 18.02.2008, të një automjeti të llojit “Mercedes Benz”, me vlerë 450.000 lekë.
 - ii. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010, subjekti deklaroi blerje automjeti të llojit “Peugeot 307”, me vlerë 400.000 lekë, më datë 29.07.2010, me të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit të mëparshëm.
 - iii. Në deklaratën *vetting*, për automjetin subjekti ka deklaruar automjet me targa {***}, të llojit “Peugeot 307”, me vit prodhimi 2002, i blerë me kontratën noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 29.07.2010. Në këtë deklaratë nuk deklarohet burimi i të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie.

- iv. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e pasurisë së tij të llojit automjet, si pasojë e shitjes në datën 06.03.2009 të automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, me çmimin prej 400.000 lekësh shtetasit A.R dhe të ardhurën e krijuar si pasojë e shitjes në vlerën e çmimit të shitjes prej 400.000 lekësh.
 - v. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin gjyqësor, automjeti i llojit “Peugeot 307”, me vit prodhimit 2002, është blerë nga subjekti i rivlerësimit në korrik të vitit 2010, ndërkohë që shitja e automjetit të mëparshëm, çmimi i shitjes së të cilit ka shërbyer sipas subjektit si burim për blerjen e “Peugeot 307”, ka ndodhur në mars të vitit 2009.
27. Pretendimi i subjektit se deklarimi i çmimit të shitjes së automjetit në vitin 2009 nuk është kryer, pasi në të njëjtin vit ai ka kryer pagesën për blerjen e automjetit tjetër, pavarësisht se kontratën e blerjes e ka lidhur në vitin 2010 (rreth 17 muaj më vonë), vlerësohet nga trupi gjykues si i pabazuar në prova, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar këtë fakt.
28. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim, sipas të cilit subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave në deklaratën e interesave privatë (periodikë/vjetorë) të vitit 2009, duke mos deklaruar vlerën prej 400.000 lekësh, të përfituar nga shitja e automjetit “Mercedes Benz” në pronësi të tij.
29. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.7 më sipër, sipas të cilit subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit në vendim, lidhur me deklarimin e të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës gjatë vitit 2006, trupi gjykues konstaton se në deklaratën fillestare para fillimit të detyrës të datës 02.11.2006, subjekti ka deklaruar si të ardhura të përfituara si student në Shkollën e Magjistraturës shumë prej 928.800 lekësh, për periudhën 2004-2006, ndërkohë që në deklarimin e tij vijues, në deklaratën periodike të interesave privatë për vitin 2006, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së në mars të vitit 2007, subjekti rezulton të ketë deklaruar si të ardhura të tij, përveç të ardhurës nga paga si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, edhe të ardhurat nga bursa e marrë si student pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën takuese 01.01.2006-04.10.2006, në vlerën 354.660 lekë.
30. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht faktit që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy herë brenda të njëjtit vit të ardhurën e përfituar nga bursa si student pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin 2006, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, kjo pasaktësi në deklarim nuk mund të ngrihet në nivelin e pasaktësive të kërkuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasaktësinë në deklarim, sa i takon kësaj të ardhure.
31. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.8 më sipër, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni, në vlerësim të pretendimeve të subjektit lidhur me këtë analizë financiare, trupi gjykues pasi i mori ato në shqyrtim, vlerëson në vijim për secilin prej viteve që kanë rezultuar me balanca negative.

32. Në lidhje me analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për vitin 2011, për të cilën Komisioni ka arritur në konkluzionin se rezultati financiar paraqitet me balancë negative në shumën -279.630 lekë, subjekti i rivlerësimit e kundërshton atë për arsyet e mëposhtme.

32.1. Për shpenzimet e llogaritura nga Komisioni për konsum familjar për vitin 2011, në shumën 560.000 lekë, subjekti pretendon se ato janë të larta dhe se Komisioni nuk referon në asnjë metodologji, standard të miratuar apo statistika të publikuara nga INSTAT. Subjekti në ankim i kërkon Kolegjit që llogaritja e këtyre shpenzimeve të bëhet bazuar në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes janar-dhjetor 2014, referuar qarkut Korçë, e publikuar nga INSTAT, në kushtet kur një anketë e tillë mungon për vitin 2011. Subjekti kërkon që për llogaritja për familjen e tij, e cila ka qenë me dy persona në vitin 2011, të bëhet në bazë të të dhënave të tabelës A2 (faqe 13 e Anketës). Sipas tij, duke iu referuar këtyre të dhënave zyrtare, shpenzimet për konsum për familjen e tij në vitin 2011 duhet të llogariten në masën prej 354.664 lekësh.

32.2. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit i referohet në mënyrë të gabuar tabelës A2, pasi referimi i duhur është ai në Figurën 2 dhe në Tabelën 2 (faqe 4 e Anketës), në të cilat tregohet se shpenzimet mesatare mujore për konsum të njësisë ekonomike familjare, me madhësi mesatare prej 3,6 personash, në qarkun e Korçës, janë në vlerën prej 57.633 lekësh. Nëse shpenzimet për konsum familjar për vitin 2011, për familjen e subjektit të rivlerësimit, me 2 pjesëtarë, do të për llogariten mbi bazën e këtyre të dhënave, atëherë ato do të jenë në shumën prej 384.222 lekësh. Në këtë rast, diferenca midis shpenzimeve të llogaritura nga Komisioni me ato të llogaritura sipas mënyrës së treguar më lart, rezulton të jetë 175.778 lekë ($560.000 - 384.222 = 175.778$).

32.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon edhe se në llogaritjen e shpenzimeve për udhëtime jashtë territorit të Shqipërisë, të bëra nga Komisioni për vitin 2011, në shumën prej 40.107 lekësh, janë përfshirë në mënyrë të padrejtë shpenzimet për një udhëtim të subjektit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ai ka qenë për vizitë studimore (zyrtare) dhe të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga pala pritëse. Nga verifikimi i kryer nga trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, rezulton se ky pretendim i subjektit është i pabazuar, pasi në llogaritjet e Komisionit nuk janë përfshirë shpenzimet për këtë udhëtim, por janë përfshirë vetëm udhëtimet private të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij.

32.4. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se në vitin 2011 Komisioni duhet të kishte përfshirë në analizën financiare edhe përdorimin prej tij, për efekt të mbulimit të shpenzimeve, të një shume prej 200.000 lekësh që subjekti e kishte deklaruar si një gjendje likuiditeti në formën e kursimit *cash*, në deklaratën e parë të bërë në vitin 2006 në momentin e fillimit të detyrës.

32.5. Për verifikimin e këtij pretendimi, trupi gjykues mori në analizë deklaratën periodike të plotësuar nga subjekti për vitin 2011. Në këtë deklaratë, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të këtë deklaruar pakësimin e kursimit të tij gjendje *cash*, të deklaruar në vitin 2006. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë mospërfshirjen e kësaj shume monetare, nga ana e Komisionit, në analizën financiare të subjektit për vitin 2011.

32.6. Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se në tabelën e analizës financiare të bërë nga Komisioni në vendimin e tij për vitin 2011 (faqe 15 e vendimit), elementi që mund të korrigjohet, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit, është

ai që ka të bëjë me shpenzimet për konsum familjar, duke e zvogëluar atë me vlerën prej 175.778 lekësh, sipas shpjegimeve në paragrafin 32.2 më sipër. Në këtë rast, balanca financiare e subjektit të rivlerësimit përsëri rezulton me gjendje negative në shumën - 103.850 lekë.

33. Në lidhje me analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të për vitin 2013, për të cilën Komisioni ka arritur në konkluzionin se rezultati financiar i këtij viti paraqitet me balancë negative në shumën -317.328 lekë, subjekti i rivlerësimit e kundërshton atë për këto arsye:

- a) Për mosmarrje parasysh në përlllogaritje të shumës prej 1.000.000 lekësh kursime të bashkëshortes, të krijuar nga paga e saj për periudhën janar 2007 - dhjetor 2008.
- b) Për llogaritje të gabuar të shpenzimeve për konsum familjar (shpenzimet e jetesës) në shumën prej 777.780 lekësh. Për llogaritjen e këtyre shpenzimeve, subjekti kërkon që Kolegji të bazohet në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes janar - dhjetor 2014, referuar qarkut Korçë, e publikuar nga INSTAT, duke pretenduar se në vitin 2013, kur familja e tij ka qenë me tre pjesëtarë, ato duhet të llogariten në shumën 531.996 lekë.
- c) Për llogaritje të gabuar të shpenzimeve të udhëtimit jashtë territorit të Shqipërisë në shumën prej 65.899 lekësh. Subjekti pretendon se në këtë shumë janë përfshirë gabimisht shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrjen e tij në një aktivitet zyrtar profesional, të zhvilluar në datat 4-6 qershor 2013, në Sofje, Bullgari.

Lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson si më poshtë.

33.1. Me të drejtë Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të subjektit për vitin 2013, shumën prej 1.000.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti si kursime nga puna e bashkëshortes së tij për periudhën janar 2007 - dhjetor 2008, për arsyet që janë shpjeguar më sipër në këtë vendim në trajtimin e shkakut të ankimit mbi ekzistencën e marrëdhënies së punësimit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për periudhën janar 2007 - dhjetor 2008 dhe të ardhurat përkatëse të realizuara prej saj. Në këto kushte, trupi gjykues gjen me vend edhe konkluzionin e Komisionit se blerja e pajisjeve dentare nga personi i lidhur në vitin 2013 nuk justifikohet me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, për sa kohë subjekti ka deklaruar se një pjesë e të ardhurave të krijuara nga bashkëshortja e tij ka shkuar për të mbuluar pagimin e një pjese të çmimit prej 30.200 eurosh për blerjen e apartamentit me kontratën e datës 09.11.2013, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me pasaktësinë dhe pamjaftueshmërinë e deklaramit të subjektit për këtë pasuri, në kuptim të dispozitave të sipërcituara.

33.2. Për sa i përket përlllogaritjes së shpenzimeve për konsum familjar, trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se për familjen e subjektit të rivlerësimit me përbërje prej tre pjesëtarësh në vitin 2013, bazuar në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes janar - dhjetor 2014, për qarkun Korçë, e publikuar nga INSTAT, shpenzimet për konsum familjar arrijnë në

vlerën prej 576.330 lekësh, ose 201.450 lekë më pak nga ato të llogaritura nga Komisioni (777.780 - 576.330 = 201.450).

33.3. Për sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit jashtë territorit të Shqipërisë, trupi gjykues, bazuar në aktet e fashikullit të gjykimit, e gjen të drejtë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për mospërfshirjen e shpenzimeve të udhëtimit për aktivitetin e zhvilluar në Sofje të Bullgarisë, në datat 4-6 qershor 2013 dhe, nga përlllogaritja e kryer nga Njësia e Shërbimi Ligjor, totali i shpenzimeve të udhëtimit për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur (bashkëshorten) për vitin 2013 arrin në shumën 21.030 lekë ose 44.869 lekë më pak se ato të llogaritura nga Komisioni (65.889 - 21.030 = 44.869).

33.4. Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se në tabelën e paraqitur në vendimin e Komisionit mbi analizën financiare të vitit 2013 për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të (faqe 16 e vendimit), edhe nëse do të zvogëlohen shpenzimet për konsum familjar me shumën prej 201.450 lekësh, si dhe shpenzimet për udhëtime me shumën prej 44.869 lekë, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe shpjegimet e dhëna në paragrafët 33.2 dhe 33.3 më sipër, sërish balanca financiare e subjektit të rivlerësimit për vitin në fjalë mbetet me gjendje negative në vlerën -129.897 lekë.

33.5. Në vijim të analizës së mësipërme, lidhur me shkakun e ankimit mbi analizën financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues arrin në konkluzionin se edhe me pranimin e pretendimit të subjektit për llogaritje të pasakta nga ana e Komisionit, sa u takon shpenzimeve për konsum familjar dhe atyre për udhëtime jashtë vendit, subjekti i rivlerësimit vijon të ketë mungesë burimesh financiare të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive në vitin 2011 dhe në vitin 2013.

- 34.** Në funksion të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues kontrolloi në mënyrë të plotë analizën financiare të kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për vitet 2011 dhe 2013, dhe nga ky kontroll konstatoi se Komisioni, në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me ligjin, në llogaritjen e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit për këto vite ka përfshirë edhe dietat e përfituara prej tij në funksion të mbulimit të shpenzimeve për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme profesionale, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.
- 35.** Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë *vetting* rezulton se subjekti ka deklaruar si të ardhura nga dietat për pjesëmarrje në seminare, trajnime të ndryshme dhe tryeza të rrumbullakëta për periudhën 2010 – janar 2017 vlerën prej 690.885 lekësh dhe 400 USD. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2011 dhe atë të vitit 2013, rezulton të ketë deklaruar përkatësisht si të ardhura nga dietat shumën prej 125.000 lekësh për vitin 2011 dhe shumën prej 83.000 lekësh dhe 400 USD (40.952 lekë) për vitin 2013. Këto shuma janë përfshirë nga Komisioni në tabelën e analizës financiare për vitet përkatëse si të ardhura nga paga.
- 36.** Trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti si të përfituara në formën e dietës, janë vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Në këto kushte, përfshirja e kësaj shume nga Komisioni, si e ardhur nga paga, rrit në mënyrë artificiale të ardhurat e subjekteve në analizën financiare, duke deformuar rezultatin e kësaj analize në kundërshtim me ligjin.

37. Gjithashtu rezulton se Komisioni, në mënyrë të gabuar, në tabelën e analizës financiare për vitin 2013 ka përfshirë në rubrikën “pakësuar gjendja e likuiditeteve *cash*” kursimin e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2006, gjendje *cash* në shumën prej 200.000 lekësh, si dhe kursimin e deklaruar të shtuar në gjendje *cash* në shumën prej 200.000 lekë në vitin 2007. Trupi gjykues arrin në konkluzionin e mësipërm, për arsye se, për sa kohë në deklaratën periodike të vitit 2013 subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë këto kursime dhe as si pakësim të gjendjes *cash* të deklaruar në vitet 2006 dhe 2007, në shumën totale prej 400.000 lekësh, Komisioni pa asnjë arsye të ligjshme e ka prezumuar përdorimin e këtij likuiditeti në vitin 2013, gjatë të cilit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka krijuar pjesën më të madhe të pasurisë së tij, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.
38. Vlerësimi i gabuar i situatës faktike dhe interpretimi i gabuar i ligjit nga Komisioni për çështjet e trajtuara më sipër, në paragrafët 36 dhe 37, ka sjellë si pasojë një vlerësim të gabuar të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2011 dhe veçanërisht për vitin 2013, kur është krijuar pjesa më e madhe e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.
39. Bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin që për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen të mos konsiderojë si të ardhura të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, vlerat monetare të përfituara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale ku ata kanë qenë pjesëmarrës, si dhe të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.
40. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.9 më sipër, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi zbatimin nga ana e Komisionit të standardeve të dyfishta në vendimmarrjet e tij, sa u takon pasaktësive në deklaratat periodike dhe atyre në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe vlerësimit jo të njëjtë të diferencave të pambuluara me burime të ligjshme të evidentuara nga analiza financiare e subjekteve të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për ta konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale

41. Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.10 më sipër, për denoncimin e shtetasit A.D, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e arritura nga Komisioni lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2014, si të pabazuara në ligj dhe në prova, trupi gjykues konstaton se Komisioni, pasi ka shqyrtuar këtë denoncim², ka arritur në konkluzionin se bazuar në kriteret e parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

² Me anë të këtij denoncimi, shtetasi A.D pretendonte përdorimin e diplomave të falsifikuara nga dy pedagogë të Universitetit {***}, {***}, të lëshuara nga Universiteti {***}, {***}, Bullgari.

subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim të thelluar dhe të plotë në lidhje me çështjen penale në fjalë.

42. Nga vlerësimi i akteve të fashikullit gjyqësor rezulton se me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2015, Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë materialet e ardhura nga autoritetet kompetente bullgare, në përgjigje të kërkesës për ndihmë juridike (letërporosisë), lidhur me procedimin penal nr. {***}, të vitit 2014. Nga këto materiale rezulton se shtetasit M.Ç dhe F.Ç kanë ndjekur studimet dhe janë diplomuar për nivelin Master pranë Universitetit Jugperëndimor {***}, {***}, Bullgari.
43. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson të drejtë vendimin datë 09.06.2015 të subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2014, për sa kohë që kjo çështje lidhet me veprën penale të falsifikimit ose përdorimit të dokumenteve të falsifikuara shkollore, të parashikuar në nenin 187 të Kodit Penal dhe për sa kohë nga hetimet e kryera rezultoi se diplomat e këtyre dy shtetasve nuk ishin të falsifikuara. Për sa analizuar më sipër, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar konkluzionin e arritur nga Komisioni lidhur me këtë çështje.
44. Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.11 më sipër, sipas të cilit subjekti pretendon se Komisioni në kundërshtim me përcaktimet e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës ka shqyrtuar çështjen penale që lidhet me denoncimin e shtetasit A.LI (në emër të shtetasit M.M), edhe pse ajo është çështje ende në shqyrtim, si dhe ka tejkalluar parashikimet ligjore lidhur me kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve, të përcaktuara nga neni E i Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konstaton se:
 - i. Shtetasi A.LI, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.02.2018, ka paraqitur denoncim pranë Komisionit për subjektin të rivlerësimit Elsion Sadiku, duke pretenduar marrjen në mënyrë të padrejtë të vendimit, datë {***} “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 31.10.2017, për kryerje akt-ekspertimi me të dhëna dhe rezultate të rreme.
 - ii. Sipas denoncimit, shtetasi M.M, i përfaqësuar me prokurë nga z. A.LI, ka qenë palë e paditur në një proces civil në Gjykatën e Apelit Korçë. Ekspertët e caktuar nga gjykata, B.T dhe R.P, pasi morën detyrat e caktuara prej saj, kanë paraqitur një akt ekspertimi me të dhëna dhe rezultate të rreme. Për këtë arsye, denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kundër dy ekspertëve, për kryerje ekspertimi me të dhëna dhe rezultate të rreme.
 - iii. Prokurori Elsion Sadiku, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.11.2017, ka njoftuar z. M.M për vendimin e “Mosfillimit të procedimit penal të datës {***}”. Denoncuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku ka kundërshtuar vendimin për “Mosfillimin e procedimit penal”, të marrë nga subjekti Elsion Sadiku.
 - iv. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2018, bazuar në nenet 290, 291 dhe 371 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së ankuesit M.M, prishjen e vendimit të datës {***} për “Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {***} të vitit 2017” të subjektit Elsion Sadiku, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit dhe vazhdimin e hetimeve.

- v. Ndaj këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim më datë 02.02.2018 përpara Gjykatës së Apelit Korçë. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. {***}, datë 29.05.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 24.01.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
 - vi. Subjekti i rivlerësimit, edhe pas vendimit të Gjykatës së Apelit, nuk e ka filluar procedimin penal sipas urdhërimit të gjykatës, por sikurse ka deklaruar në seancën dëgjimore në Komision, ka hequr dorë nga çështja, megjithëse një gjë e tillë nuk është e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale. Fakti i heqjes dorë nga procedimi penal, sipas subjektit, lidhet me bindjen e tij personale dhe qëndrimin e mëparshëm në çështje të ngjashme, ku për efekt prove ka depozituar “Deklaratën për heqje dorë nga procedimi penal nr. {***} i vitit 2017”.
45. Komisioni, lidhur me këtë çështje, pasi ka dëgjuar shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore, ka arritur në konkluzionet e arsyetuara si vijojnë:
- i. *Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, madje nuk ka kryer asnjë veprim hetimor që do të çonte në një analizë të plotë e, për pasojë, në një përfundim të saktë, për faktet e kallëzuara nga kallëzuesi M. M. Ai nuk ka hetuar në lidhje me ekzistencën ose jo të fakteve dhe, për rrjedhojë, nuk ka bërë një analizë me qëllim arritjen në konkluzionin nëse kemi të bëjmë ose jo me veprë penale.*
 - ii. *Subjekti, në arsyetimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, datë {***}, për rastin konkret, ka hedhur poshtë një figurë të veprës penale, siç është “Ekspertimi i rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal.*
 - iii. *Subjekti, me veprimet dhe mosveprimet e tij, i ka mohuar kallëzuesit të drejtën e rishikimit të vendimit civil, parashikuar nga neni 494/b i Kodit të Procedurës Civile.*
 - iv. *Është i pabazuar arsyetimi i subjektit se nuk mund të hetojë një vendim gjykate të formës së prerë, sepse nuk kemi të bëjmë me një kallëzim penal ndaj një vendimi gjykate, por për kryerje ekspertimi të rremë me të dhëna të rreme. Pavarësisht se vendimi gjyqësor civil, ku është administruar akti i ekspertimit, i pretenduar i falsifikuar, ka marrë formë të prerë, kjo nuk përjashton mundësinë e ekzistencës së veprës penale të ekspertimit të rremë të kryer nga ekspertë të thirrur nga gjykata. Kallëzuesi ka kërkuar ndjekje penale për shtetasit R. P. dhe B. T., në cilësinë e ekspertëve të thirrur nga Gjykata e Apelit Korçë, për paraqitje akt ekspertimi me të dhëna dhe rezultate të rreme.*
 - v. *Pavarësisht aspektit civil të aktit, fakti se në organin procedues është paraqitur një kallëzim penal për ekzistencën e një veprë penale që lidhet me këtë akt dhe, në kuadër të një hetimi penal, prokurori është i detyruar ligjërisht t’u japë përgjigje pretendimeve të kallëzuesit për ekzistencën ose jo të veprës penale të ekspertimit të rremë.*
 - vi. *Pretendimi nga ana e kallëzuesit për pasqyrim të deformuar nga ana e ekspertëve të thirrur nga gjykata, të të dhënave pasurore, përfshirë edhe kufijtë, si rezultat i një ballafaqimi jokorrekt dhe të qëllimshëm nga ana e tyre të pasqyrimin të saktë të vendndodhjes së pasurive objekt konflikti në terren, me të dhënat e tyre në*

dokumentet ligjore (AMTP, harta treguese e pasurisë, kartela e pasurisë së paluajtshme), janë elemente të mjaftueshme që do të shërbenin si indicie për regjistrimin nga ana e prokurorit të procedimit penal për veprën penale të ekspertimit të rremë.

Për sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se nga subjekti i rivlerësimit jo vetëm nuk është kryer hetim i thelluar, por nuk është kryer asnjë veprim hetimor për të provuar konsumimin ose jo të veprës penale “ekspertim i rremë” (neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016).

46. Në ankim subjekti pretendon se kjo çështje si në momentin kur është shqyrtuar nga Komisioni, por edhe aktualisht, është në proces hetimi. Në këto kushte, subjekti pretendon se ndodhemi para rastit të parashikuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se vlerësimi i aftësive nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.
47. Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues çmon se denoncimi i bërë nga shtetasi A.LI, në emër të denoncuesit M. M., për sa u përket veprimeve dhe mosveprimeve procedurale të subjektit të rivlerësimit, nuk duhet konsideruar si një çështje në shqyrtim, pasi çështja konkrete që ka vlerësuar Komisioni lidhet vetëm me vendimmarrjen për fillimin ose jo të procedimit penal. Në kohën që Komisioni ka bërë rivlerësimin e subjektit Elision Sadiku, ky moment procedural rezulton të ketë qenë i zgjidhur në mënyrë përfundimtare, sipas vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Korçë, si më sipërcituar, dhe për këtë arsye, Komisioni, sa i takon vlerësimit mbi fillimin ose jo të procedimit penal, nuk ishte në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar në ligj dhe në prova këtë shkak ankimi.
48. Trupi gjykues konstaton se mosveprimi i subjektit të rivlerësimit pas dhënies së vendimeve gjyqësore që e urdhëronin atë të fillonte hetimet për materialin kallëzues të denoncuesit, nëpërmjet heqjes dorë nga çështja për arsye tërësisht subjektive, të pambështetura në ligj, tregon mungesë profesionalizmi, mosrespektim të autoritetit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që urdhërimi i gjykatës për çështje të kësaj natyre është i detyrueshëm për prokurorin, mosrespektim të të drejtave të qytetarëve kallëzues, duke sjellë si pasojë zvarritjen e hetimit të çështjes, si dhe cenim të etikës dhe mosangazhim ndaj vlerave profesionale. Gjithsesi, problematika e këtij rasti nuk është e mjaftueshme për ta klasifikuar subjektin e rivlerësimit me “mangësi profesionale”, sipas nenit 44, pika b e ligjit nr. 84/2016.
49. Pavarësisht sa më sipër, fakti që kjo sjellje procedurale e subjektit të rivlerësimit nuk është një rast i vetëm, i izoluar në karrierën e tij si prokuror, por sikundër ka pohuar vetë subjekti para Komisionit në seancën dëgjimore, është një sjellje e vazhdueshme, e provuar edhe nëpërmjet akteve të paraqitura prej tij si provë, e çon trupin gjykues në konkluzionin se kjo sjellje e subjektit cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit lidhur me trajtimin e këtij denoncimi çmohet i drejtë.
50. Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 4.13 më sipër, sipas të cilit subjekti pretendon zbatim të gabuar të ligjit nga ana e Komisionit në arritjen e konkluzionit se ai ka cenuar besimin e publikut (sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016) vetëm mbi bazën e dy denoncimeve të dy personave që kanë pasur probleme me ligjin, duke qenë se besimi i publikut të gjerë nuk mund të përfaqësohet nga këta dy denoncues, trupi gjykues e gjen të pabazuar atë, për sa kohë Komisioni në vendimin e tij është shprehur në mënyrë të qartë se në arritjen e konkluzionit mbi cenimin e besimit të publikut nga subjekti i

rivlerësimit nuk është bazuar vetëm mbi dy denoncimet e shqyrtuara, por në vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë dhe atij të aftësive profesionale.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:

1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurive, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruar, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë kriter, lidhur me burimet financiare të ligjshme, për të justifikuar një pjesë të pasurive të tij në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
2. Nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
3. Për rrjedhojë, vendimi nr. 50, datë 27.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me shumicë votash, në zbatim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 61, pikat 3 dhe 5, 66, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 50, datë 27.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 05.04.2019.

ANËTARE

Albana Shtylla

nënshkrimi

ANËTAR

Luan Daci

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi

RELATORE

Ina Rama

nënshkrimi - kundër

KRYESUES

Ardian Hajdari

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Elsion Sadiku kundër vendimit nr. 50, datë 27.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nëpërmjet të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të mësipërm të Komisionit dhe është konfirmuar shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Elsion Sadiku. Kam votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elsion Sadiku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Më poshtë do të rendis arsyet e votës sime kundër, duke u ndalur dhe arsyetuar qëndrimet e mia kundër konkluzioneve që ka mbajtur shumica e trupit gjykues në këtë çështje, pa përsëritur argumentet e dhëna nga shumica për çështje për të cilat kam ndarë të njëjtin qëndrim me të.
3. Kam gjetur të drejta pjesën më të madhe të shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka qenë objekt shqyrtimi nga Kolegji.
4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vendimin nr. 50, datë 27.07.2018, pasi ka hetuar dhe vlerësuar subjektin e rivlerësimit Elsion Sadiku për të tria kriteret mbi të cilat zhvillohet procesi i rivlerësimit, ka konkluduar në përfundim të hetimit administrativ se:
 - a) *Nga vlerësimi i secilit prej tri kriterëve:*
 - *Nuk ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, sepse ka pasaktësi në deklarin e burimeve financiare, deklarin të pamjaftueshëm të të ardhurave, ka burime financiare të paligjshme, si dhe balancë financiare negative për vitet 2011 dhe 2013, duke bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë (neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016).*
 - *Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës (neni 59/b i ligjit nr. 84/2016).*
 - *Është “me mangësi” në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 44/b i ligjit nr. 84/2016).*
 - b) *Nga vlerësimi tërësor i kriterit të pasurisë dhe aftësive profesionale, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë (neni 61/5 i ligjit nr. 84/2016).*
5. Kundër këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shkaqet mbi të cilat argumenton pabazueshmërinë e vendimit të marrë prej Komisionit, shkaqe të cilat janë trajtuar individualisht në arsyetimin e vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues.
6. Në mbështetje të qëndrimit kundër, po argumentoj në vijim arsyet mbi të cilat kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, të cilat në përfundim më kanë çuar në mendimin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhej të ndryshohej e subjekti i rivlerësimit Elsion Sadiku të konfirmohej në detyrë.

I. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë

7. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se padrejtësisht Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk i ka njohur si një të ardhur të ligjshme shumën prej 1.000.000 lekësh, të deklaruar që në deklaratën periodike të vitit 2008, si të ardhura të bashkëshortes së tij, të fituara nga puna e saj si stomatologe pranë klinikës dentare {***}. Sipas këtij pretendimi, bashkëshortja këto para i ka fituar para se të lidhte martesën ligjore me subjektin e rivlerësimit dhe ai i ka deklaruar si të tilla që në deklaratën e parë që personi i lidhur ka bërë, në vitin 2008 (e cila dorëzohet në mars 2009), pas martesës së tyre ligjore, e cila rezulton të jetë kryer në janar 2009.
8. Përtej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se detyrimi për pagimin e detyrimeve tatimore për shkak të kësaj marrëdhënieje punësimi i takonte punëdhënësit, kam ndarë të njëjtin qëndrim me shumicën se subjekti nuk arriti të provonte bindshëm ekzistencën e kësaj marrëdhënieje punësimi në drejtim të të gjitha elementeve të një kontrate pune që legjislacioni në fuqi kërkon. Në vijim të këtij qëndrimi, kam ndarë të njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues se, për shkak të mosprovimit të kësaj marrëdhënieje edhe konsiderimi në analizën financiare i shumës prej 1.000.000 lekësh, të pretenduara se janë produkt i saj në kushtet kur për arkëtimin e të cilave nuk ekziston asnjë dokument ligjor, nuk do të mund të përdoren si e ardhur që duhej të llogaritej.
9. Pavarësisht këtij konkluzioni, kam vlerësuar ndryshe nga shumica, se të dhënat që vijnë në dijeni të trupës rreth ekzistencës së kësaj marrëdhënieje kanë indikatorë të rëndësishëm, që të bëjnë të besosh se një marrëdhënie e shkëmbimit të shërbimeve profesionale kundrejt pagesës, mes bashkëshortes së subjektit dhe klinikës {***}, ka ekzistuar për vitet e pretenduara 2007-2009.
10. Këtë qëndrim e mbështes në të dhënat që vijnë nga aktet e paraqitura prej subjekti të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, të cilat dëshmojnë në vlerësimin tim të paktën për ekzistencën e një burimi që ka prodhuar të ardhura për bashkëshorten e subjektit. Si të tilla, do të rendisja:
 - Deklarimet e dhëna prej stomatologut S.B, në drejtim të këtij fakti, apo ato të pacientëve V.B e S.A.
 - Blloku i operimit të klinikës {***}, në të cilin subjekti pretendon se ka nënshkrime të bashkëshortes për kohën e pretenduar; fakti që subjekti ka paraqitur dhe ka kërkuar që të konsiderohet ekspertimi grafik i këtyre nënshkrimeve edhe nga Kolegji, tregon se ai është i bindur dhe i sigurtë në pretendimin e tij.
 - Fakti që kjo marrëdhënie është deklaruar në deklaratën e vitit 2008, e cila kryhet në mars 2009, ende pa u formalizuar marrëdhënia e punës së bashkëshortes së subjektit me këtë klinikë, në korrik të vitit 2009.
 - Fakti që bashkëshortja e subjektit, natyrshëm në moshën që ajo kishte në vitin 2007, kur ishte e sapodiplomuar dhe në kërkim të gjetjes së një mundësie për të ushtruar profesionin, në konsideratë të tregut shqiptar në marrëdhëniet e punësimit, nuk ishte në kushtet të diktonte rregulla për punësimin e saj, por do të pranonte të punonte e të përfitonte në kushtet që mund t'i ofroheshin në një kontekst kohor, social e rrethanor të caktuar.

11. Për të gjitha këto rrethana, kam mbajtur qëndrimin se ndonëse subjekti nuk arrin të provojë bindshëm ekzistencën e marrëdhënies së punës për personin e lidhur dhe as të ardhurat e pretenduara se janë fituar prej saj, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, por edhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, konkluzioni i mësipërm drejt pranisë së ekzistencës së një marrëdhënieje të shkëmbimit të shërbimeve profesionale kundrejt pagesës, mes bashkëshortes së subjektit dhe klinikës {***}, është një e dhënë që duhet të konsiderohet në këndvështrim të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, bazuar në zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit në kuptim të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të neneve 12 e 14 të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative
12. Në drejtim të shkakut tjetër të ankimit, kundër qëndrimit të Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë të të ardhurave të personit të lidhur për vitin 2009, pasi ka deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë shumë prej 540.000 lekësh, ndërkohë e provueshme nëpërmjet legjislacionit tatimor është vetëm shuma prej 91.104 lekësh, kam ndarë qëndrim të ndryshëm me shumicën e trupit gjykues, duke mos e konsideruar këtë deklarim të vitit 2009 si një pasaktësi që mund të ngrihet në nivel të një shkakut për shkarkimin e subjektit.
13. Siç ka rezultuar nga hetimi në vitin 2009, subjekti ka deklaruar si të ardhur nga puna e bashkëshortes shumë prej 540.000 lekësh, duke pretenduar në mënyrë konsistente që kjo ka qenë shuma që faktikisht ajo ka përfituar atë vit dhe se në këtë mënyrë subjekti ka plotësuar detyrimin ligjor të kohës, në kuptim të ligjit nr. 9043, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, për të deklaruar me vërtetësi të ardhurat e fituara realisht, të palidhura këto në mënyrë detyruese me të ardhurën e ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
14. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit për këtë të ardhur në deklaratën *vetting*, rezulton se kjo e ardhur është deklaruar aty vetëm në shumë prej 91.104 lekësh, shumë për të cilën në vitin 2009 janë paguar detyrimet tatimore prej punëdhënësit S.B, dhe se subjekti ka reaguar në këtë deklarim sipas përcaktimeve ligjore të specifikuara e miratuara në Aneksin e Kushtetutës e ligjin nr. 84/2016. Në vijim të këtij deklarimi, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për këtë vit ka përfshirë si të dhënë të fituar prej personit të lidhur, pikërisht shumë prej 91.104 lekë. Në vijim, në vitet përkatëse, subjekti ka deklaruar në vazhdimësi vetëm shumë prej të cilën personi i lidhur ka qenë i siguarur që, në vlerësimin tim, tregon koherencë me shpjegimet që ai jep dhe që u referohen rrethanave të faktit. Dakordësia për pagesa më të ulëta në një marrëdhënie punësimi, në kundërshtim me logjikën se ato duhet të vijnë duke u rritur, mendoj se përbën një element që mund të analizohet në këndvështrim të disa rrethanave që kanë shtyrë palët në arritjen e një marrëveshjeje të tillë, por nuk mund të konsiderohet si e dyshuar *a priori*, vetëm për një moskonsistencë logjike në mënyrën se si kanë rrjedhur situatat, aq më shumë për ta kualifikuar deklarimin në fjalë si një shkelje të ligjit në nivelin e një shkakut shkarkimi. Këtij arsyetimi do t'i shtoja edhe argumentin ligjor që lidhet me vlerën e pasaktësive në deklaratat periodike, të cilat edhe kur konstatohen si të tilla, nuk mund të përbëjnë në vlerësimin tim shkaqe për shkarkim të subjekteve të rivlerësimit, për sa kohë që ato nuk shoqërohen me elemente të tjera që e ngrenë atë në nivelin e një shkakut shkarkimi. Vetë

parashikimet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me nenin 33, pika 5 e po këtij ligji, nuk parashikojnë pasaktësinë në vetvete, aq më tepër në deklaratën periodike, si një shkak që mund të legjitimojë shkarkimin e një subjekti rivlerësimi nga detyra.

15. Në lidhje me shkakun e ankimit kundër qëndrimit të Komisionit, që konsideron mosdeklarimin e shitjes së një makine në vitin 2009 si deklaram të pamjaftueshëm, për pasojë si një shkak për shkarkim nga detyra, kam ndarë gjithashtu qëndrim të ndryshëm me vlerësimin që ka bërë shumica.
16. Nga hetimi administrativ, në drejtim të këtij pretendimi, ka rezultuar dhe është pranuar si e mirëqenë, qoftë nga Komisioni, qoftë nga shumica se subjekti i rivlerësimit ka shitur në vitin 2009 automjetin tip “Mercedes Benz” në vlerën prej 400.000 lekë, e provuar nga kontrata e shitjes, datë 06.03.2009. Në deklaratën periodike të këtij viti, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këtë veprim juridik, i cili do të duhej të pasqyrohej në formën e pakësimit të pasurisë së paluajtshme makinë dhe shtimin e të ardhurave të përfituara nga shitja e saj, në vlerën 400.000 lekë. Në vitin 2010, sipas kontratës së shitblerjes datë 29.07.2010, rezulton se subjekti ka blerë automjetin tip “Peugeot” në vlerën 400.000 lekë, pra aq sa kishte shitur automjetin një vit më parë. Këtë fakt, blerjen e këtij automjeti, ai e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010, duke deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie, paratë e ardhura prej shitjes së automjetit tip “Mercedes Benz”. Në shpjegimet që subjekti jep për mosdeklarimin e këtij fakti në deklaratën periodike të vitit 2009, ai ka pretenduar se faktikisht automjetin “Peugeot” e ka marrë në posedim që në vitin 2009, menjëherë pas shitjes së automjetit “Mercedes Benz” dhe për të njëjtën vlerë që kishte shitur automjetin e mëparshëm, ndërsa veprimin juridik formal e ka realizuar në vitin 2010, për shkak se shitësi i automjetit nuk ishte i pajisur më dokumentacionin e duhur ligjor për pronësinë mbi mjetin, në mënyrë që të realizohej kontrata e shitjes.
17. Pra, ajo që konstatohet nga analiza e situatës faktike dhe që përbën pasaktësi në plotësimin e deklaratës periodike të vitit 2009, është mosdeklarimi i shitjes së automjetit “Mercedes Benz” dhe mosdeklarimi i të ardhurës prej 400.000 lekësh prej këtij veprimi juridik. Në vlerësimin tim, pavarësisht shpjegimeve të subjektit, mendoj që mosdeklarimi i këtyre ndryshimeve përbën pasaktësi në deklarimin periodik të vitit 2009, por që mbeten thjesht të tilla dhe nuk mbështeten nga veprime të subjektit të rivlerësimit për të fshehur pasuri apo për të dhënë deklarime të pavërteta. Aq më shumë që logjikisht duket se subjekti nuk kishte asnjë motiv që të fshihte dhe mos deklaronte të ardhurat e krijuara prej shitjes së një pasurie të fituar në mënyrë të ligjshme e të transferuar po në mënyrë të ligjshme te të tretët. Në këtë këndvështrim, nuk gjej të aplikueshëm në këtë rast parashikimin për deklarim të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5 në asnjë prej germave të kësaj pike të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që parashikimi kushtetues i nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës e lidh gjithmonë defektin në deklarime me përpjekje për të fshehur apo mos deklaruar saktë, që do të thotë se duhet të ekzistojë një qëllim për të defektuar deklarimin.
18. Përveç këtyre argumenteve, vlerësoj se vlen edhe në këtë rast, arsyetimi i bërë më sipër në drejtim të pasaktësive të konstatuara në deklaratat periodike, të cilat nuk mund të

konsiderohen si shkaqe shkarkimi kur ato mbeten të pashoqëruara me elemente që plotësojnë rekuizitat e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

19. Në lidhje me shkaqet e ankimit që i drejtohen analizës financiare të kryer në Komision, kam mbajtur qëndrime të ndryshme në raport me shumicën në disa elemente që janë trajtuar në kuptim të shkaqeve të ankimit, qëndrime që çojnë në një konkluzion të përafërt financiar me atë që pranon shumica, por duke ndjekur arsyetim të ndryshëm.
20. Së pari, në drejtim të analizës financiare që i përket vitit 2011, në të cilën sipas qëndrimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka një situatë financiare negative në vlerën prej - 279.630 lekësh, ndahem në raport me qëndrimin që ka mbajtur shumica në drejtim të përdorimit si burim të ardhurash për pagimin e këstit të parë të shtëpisë edhe shumë prej 200.000 lekësh, të deklaruar prej subjektit të rivlerësimit si kursim në gjendje *cash* në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2006.
21. Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti vërtet nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* për pagimin e këstit të parë për blerjen e një shtëpie, por ka deklaruar si burim për pagimin e kësaj shume, kursimet në vite të tij dhe të bashkëshortes së tij. Pra, pavarësisht se ai nuk ka përcaktuar në deklaratën periodike qartësisht shumë e përdorur për kryerjen e pagesës, ka deklaruar qartë se ajo është përballuar prej kursimeve të subjektit të deklarimit dhe bashkëshortes së tij, dhe e ka sqaruar më pas në procesin e pyetjes dhe dhënies së deklarimeve gjatë hetimit administrativ se ka përdorur pikërisht këtë shumë për të realizuar kryerjen e pagesës. Ajo që është e rëndësishme, në vlerësimin tim, në trajtimin e këtij shkaku ankimi, është se deklarimi që subjekti ka bërë që në vitin 2011 për përdorimin e kursimeve të tij, është i mundur dhe i besueshëm për sa kohë që subjekti i gëzonte këto kursime atë vit dhe nuk kishte deklaruar më parë përdorim të tyre dhe, për më tepër, në vlerësim të analizës së kryer për mundësinë e krijimit të këtyre kursimeve, rezulton se ai ka pasur mundësi t'i realizojë ato me burime të ligjshme.
Në versionin që kjo shumë e kursimeve të tij përdoret si e ardhur në analizën financiare të vitit 2011, krahas korrektimit që bën shumica në lidhje me shpenzimet e jetesës, bilanci financiar për këtë vit, sipas këshillimit të Njësisë së Shërbimit Ligjor, do të rezultonte pozitiv.
22. Në drejtim të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2013, i cili është viti i dytë për të cilin Komisioni ka konkluduar për një diferencë negative në vlerën prej – 317.328 lekësh, rezulton se në reflektim të shkaqeve të ankimit, siç pranohet edhe nga shumica e trupit gjykues, duke korrigjuar vlerën e shpenzimeve për jetesë të subjektit të rivlerësimit dhe duke zbritur gjithashtu nga të ardhurat e këtij viti shumë prej 200.000 lekësh, të ardhura nga kursimet e viteve 2006 e 2007, për shkak se u përdorën si të ardhura në analizën financiare të subjektit për vitin 2011, bilanci financiar i subjektit të rivlerësimit për vitin 2013, duke përdorur të dhënat e përdorura nga Komisioni dhe të korrigjuara vetëm mbi shkaqet e parashtuara në ankim, sipas këshillimit të Njësisë së Shërbimit Ligjor, do të ishte në vlerën –328.947 lekë.
23. Në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga shumica në raport me konsiderimin ose jo të dietave si e ardhur, mendoj që përveç zbatimit të legjislacionit tatimor për përcaktimin e tyre, do të duhej të trajtohej edhe situata faktike që përcakton përfundimin e tyre. Në këtë kontekst, mendoj se do të ishte e rëndësishme që të specifikohesh natyra e aktivitetit për të cilin dieta akordohet, vendi i zhvillimit, programi i vizitës nëse do kemi një të tillë, që do

të thotë minimalisht subjektit të rivlerësimit do t'i duhej të shpjegohej për natyrën e këtyre dietave, në mënyrë që të kryhej një kualifikim dhe kategorizim i saktë për trajtimin e tyre. Në çështjen objekt gjykimi, ky proces nuk rezulton të jetë kryer dhe Komisioni ia ka konsideruar subjektit këto shifra si të ardhura dhe, duke qenë se kjo pjesë nuk ka qenë në Komision pjesë e çështjeve për shpjegim dhe sigurisht as Kolegji nuk ka pasur informacion në këtë drejtim, pasi trajtimi i tyre nga Komisioni nuk ka qenë pjesë e shkaqeve të ankimit, mendoj që konsiderimi i tyre *a priori* si shpenzime, në rastin në shqyrtim, mund të rëndonte pozitën e subjektit, pa i dhënë atij mundësi të mbrohej për këtë pjesë, dhe do të dilte jashtë juridiksionit të Kolegjit në raport me kufijtë e shqyrtimit të çështjes, për pasojë ky diskutim do të ishte irelevant në këtë rast.

24. Ndaj mendim të ndryshëm me shumicën edhe për sa i përket qëndrimit orientues të mbajtur në raport me mospresumimin e përdorimit të gjendjeve *cash* të subjektit për mbulimin e shpenzimeve, nëse për këtë nuk ka një deklaram të saktë e të qartë në këtë drejtim. Duke konsideruar parashikimet e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon mundësinë e përdorimit për provë të deklaratave periodike, dhe gjithashtu nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 për llojet e tjera të provave që merr e administron Komisioni gjatë hetimit administrativ, mendoj që përgjithësime të kësaj natyre do të vështirësonin analizën e çmuarjen e çdo prove gjatë procesit administrativ e do të zbehnin mundësinë e Komisionit për të kryer hetime e për të nxjerrë konkluzione në përfundim të tyre. Mendoj që vlera e çdo të dhëne të paraqitur në deklaratat periodike të pasurisë, duhet të çmohet në vlerësimin e përgjithshëm edhe të të dhënave të tjera që burojnë nga hetimi administrativ, me qëllim përcaktimin e saktë të vlerës provuese të deklarimeve e provimit të ligjshmërisë së burimit. Pavarësisht kësaj analize, mendoj se prezumimi i përdorimit të gjendjes *cash* për mbulim shpenzimesh, pa pasur asnjë gjurmë të këtij veprimi në deklaratat periodike, do të ishte në vlerësimin tim një zbatim i gabuar i ligjit dhe për të cilin do të orientoja të kundërtën.
25. Në analizë të gjetjeve të konstatuara për kriterin e kontrollit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në vlerësimin tim do të konsideroja si të tilla:
 - a) Mosprovueshmërinë e faktit të ekzistencës së marrëdhënies së punës së bashkëshortes në klinikën dentare {***} dhe, për pasojë, të krijimit të të ardhurave në vlerën 1.000.000 lekë.
 - b) Mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë në vitin 2013, në vlerën 328.947 lekë.
26. Në vlerësim të këtyre dy shkeljeve që lidhen me kriterin e pasurisë, kam mbajtur qëndrimin se ato duhen parë të ndërthurua në raport me njëra-tjetrën dhe duhen analizuar në zbatim të parimit të objektivitetit e proporcionalitetit, në mënyrë që të arrihet në një konkluzion sa më të drejtë për përcaktimin e nivelit të besueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1 apo të deklaramit të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
27. Mendoj që përderisa, qoftë neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, qoftë neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikojnë se subjekti i rivlerësimit duhet të provojë bindshëm/me nivel të besueshëm ligjshmërinë e burimit të pasurisë së tij, organet e rivlerësimit, Komisioni apo Kolegji, kanë të drejta diskrecionare në përcaktimin e nivelit të kënaqshëm

të provueshmërisë. Sigurisht që ky diskrecion nuk mund të jetë i pakufishëm e arbitrar, por i zbatuar me kujdesin e duhur në çdo rast dhe në vlerësim të të gjitha rrethanave që kanë ndikim në këtë lloj vendimmarrjeje.

28. Në rastin konkret, në vlerësimin tim, siç e kam thënë edhe në paragrafët më lart, subjekti i rivlerësimit vërtet dështoi të provojë të gjitha elementet e nevojshme për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së punës dhe përfitimin e shumës së pretenduar prej bashkëshortes së tij, por ai provoi indikatorë të vlefshëm për të përjashtuar situatën nga mundësia e një deklarimi të rremë dhe, për më tepër, krijoi bindjen, sipas meje, që një marrëdhënie mes bashkëshortes së tij si stomatologe dhe klinikës {***}, e cila ka gjeneruar të ardhura, ka ekzistuar, pavarësisht faktit që sasia e tyre është e pamundur të matet e provohet në kuadër të këtij procesi.
29. Në këtë analizë, do të konsideroja edhe diferencën negative të krijuar për subjektin në analizën financiare të vitit 2013, pikërisht për shkak të mospërdorimit si burim të ardhurash në këtë analizë të shumës prej 1.000.000 lekësh, por që do të ishte e ndryshme nëse subjekti do të arrinte të provonte të ardhura në çfarëdo vlere tjetër.
30. Gjithashtu, fakti se megjithëse kjo shumë nuk njihet fare si e ardhur për subjektin e rivlerësimit, në këndvështrim edhe të shpjegimeve që ai ka dhënë gjatë procesit të hetimit administrativ në drejtim të faktit se shuma prej 1.000.000 lekësh nuk ka qenë një send i trupëzuar dhe i përcaktuar individualisht, por një entitet financiar që është ndryshuar nëpërmjet pikësimeve e shtesave prej të ardhurave të tjera të subjektit e të personit të lidhur në vite, analiza e tij financiare nuk demonstroi defekte të rënda në drejtim të burimeve të ligjshme, për të justifikuar të gjitha pasuritë e të gjitha shpenzimet e tij për jetesë. Gjithashtu, edhe për aq sa vlerësohet nga shqyrtimi i dokumentacionit, standardi i tij i jetesës duket modest dhe në raport të drejtë me statusin e tij social e financiar.
31. Duke konsideruar edhe raste të tjera të hetuara nga Komisioni, për të cilat ka pasur një vlerësim edhe më të gjerë për sa u përket diferencave negative të pakonsideruara si relevante në drejtim të deklarimit të pamjaftueshëm, qëndrime të cilat kanë marrë tashmë formën e prerë, do ta vlerësoja si të tillë këtë situatë financiare, në funksion edhe të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues të subjektit të rivlerësimit në raport me subjektet e tjera të konfirmuara tashmë.
32. Përpos këtyre elementeve, do të vlerësoja si relevant në këtë trajtim edhe faktin që shuma e mësipërme është pretenduar se është fituar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, para se ajo të merrte këtë status, pra jashtë ndikimit e vëmendjes së subjektit të rivlerësimit.
33. Një element tjetër që mendoj se vlen të përmendet në këtë kontekst, është edhe fakti që blerja e pajisjeve dentare të cilat janë një pjesë e pasurisë në të cilën është përdorur si burim e ardhura nga puna, janë të blera nëpërmjet transaksionit bankar, duke përdorur një formë të kryerjes së këtij transaksioni që lë gjurmë e dokumentohet, pra duke demonstruar, në vlerësimin tim, mungesën e vullnetit për deformime apo mungesën e pasigurisë drejt ligjshmërisë së burimit, sipas këndvështrimit të subjektit.
34. Në vlerësim të këtyre rrethanave, kam vlerësuar se diferenca negative prej 328.947 lekësh në analizën financiare të subjektit, e prodhuar në një vit të vetëm (vitit 2013) dhe në

kontekstin e mësipërm, nuk duhet konsideruar si një deklaram i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi masa disiplinore e shkarkimit që shoqëron këtë përcaktim nuk është proporcionale në raport me shkeljen e konstatuar të përshkruar si më lart. Në gjykimin tim, kjo analizë do të shërbente për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë në drejtim të aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, e cila nuk mund të jetë thjesht një shifër, por duhet të përfaqësojë një qasje të subjekti të rivlerësimit në raport me pasurinë e tij dhe burimet e ligjshme.

Për shkak të këtij arsytimi, kam çmuar se në rastin e rivlerësimit të subjektit Elision Sadiku gjendemi përpara parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për sa i përket kriterit të kontrollit të pasurisë.

II. Në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional

35. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket trajtimit të vendimit në lidhje me pushimin e procedimit penal me nr. 841 të vitit 2014, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal.
36. Në thelb, jam gjithashtu dakord me qëndrimin që ka mbajtur shumica, se problematika që i përket çështjes që lidhet me materialin kallëzues për ekspertim të rremë, të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal, për të cilin subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, nuk mund të jetë e mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, në kuptim të nenit 44/b të ligjit nr. 84/2016.
37. Kam ndarë qëndrim të ndryshëm në raport me shumicën, për sa i përket trajtimit të problematikës që lidhet me dorëheqjen e prokurorit nga hetimi i çështjes, si një shkak që mund ta çonte trupën në përfundimin se ai ka cenuar besimin e publikut të dhënia e drejtësisë, së bashku me vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
38. Së pari, konstatoj se edhe Komisioni në arsyetimin e tij ka përdorur një citim të përgjithshëm dhe të papërcaktuar në drejtim të faktit se cili element i kriterit të vlerësimit të pasurisë është ai që në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka ndikuar dhe cenuar besimin e publikut të subjekti i rivlerësimit. Mendoj se përcaktimi i ligjit për vlerësimin tërësor, në rastin e aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, tregon kufij diskrecionarë, brenda të cilëve organet e rivlerësimit duhet të operojnë, duke vlerësuar elemente të caktuara e specifike, të cilat pavarësisht se nuk ngrihen në nivelin e shkeljeve të posaçme për çdo kriter rivlerësimi, meritojnë të ngrihen në nivelin e shkeljeve pas një vlerësimi të përgjithshëm të asaj që përfaqëson subjekti i rivlerësimit në raport me besimin e publikut.
Në rastin konkret, nuk gjej të identifikuar elemente konkrete që lidhen me kriterin e pasurisë, që shërbejnë si shkak për këtë klasifikim, përpos analizës së bërë më lart, në lidhje me qëndrimin tim në raport me vlerësimin e kriterit të pasurisë.
39. Në lidhje me elementin tjetër, atë të konsiderimit të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit nga hetimi i çështjes që lidhet me materialin kallëzues për ekspertim të rremë, gjykoj se një element i tillë është i pamjaftueshëm për t'u ngritur në nivelin e një shkeljeje që ka

prekur besimin e publikut. Dorëheqja e një prokurori nga hetimi i një çështjeje është një institut i së drejtës procedurale penale, i sanksionuar për të shmangur, ndër të tjera, çdo paragjykim apo njëanshmëri në trajtimin e një çështjeje. Për më tepër, prokurori i çështjes është subjekti procedural që bën kërkesën për heqje dorë, sipas parashikimeve të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale, dhe kjo kërkesë i nënshtrohet vlerësimit të drejtuesit të prokurorisë dhe, në rastin konkret, drejtuesi ka çmuar se dorëheqja është e motivuar. Mendoj se i ka takuar këtij të fundit vlerësimi nëse shkaqet e ngritura prej subjektit të rivlerësimit qëndronin ose jo.

40. Së dyti, mendoj se në ushtrim të këtij mjeti procedural që shmang paragjykimin e një çështjeje, prokurori nuk anashkalon vullnetin dhe urdhërimin e gjykatës që ka vendosur dhe urdhëruar në këtë rast që të zhvillohen hetime. Në çdo rast, për të konsideruar abuzive kërkesën për dorëheqje, mendoj se duhet të vlerësohen disa rrethana, që në këtë proces nuk na rezultojnë se ekzistojnë. Gjithashtu, në çfarëdo rasti, vetëm një situatë e tillë si ajo që lidhet me subjektin e rivlerësimit, nuk meriton të ngrihet në nivelin e një shkeljeje që ka cenuar besimin e publikut.
41. Për të gjitha sa kam arsyetuar më lart, kam votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të prokurorit Elision Sadiku, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Gjyqtare

Ina RAMA

nënshkrimi